



Financuar nga Bashkimi Evropian



Sweden
Sverige

Bashkëfinancuar nga
Bashkëpunimi Suedez për Zhvillim

TË DREJTAT E PUNËS DHE DISKRIMINIMI GJINOR



**NËSE JENI DUKE
PUNUAR NËN PRESION
OSE KENI LËNË PUNËN
TUAJ PËR SHKAK TË
DISKRIMINIMIT ME BAZË
GJINORE, KONSIDERONI
MUNDËSINË TË FLISNI
ME NJË AVOKAT OSE
KËSHILLUES LIGJOR PËR
TË DISKUTUAR SITUATËN
TUAJ LIGJORE**

KËSHILLUESI LIGJOR MUND TË:

a) Shpjegojë ligjin që zbatohet,

b) T'ju ndihmojë të mblidhni provat e duhura për ankimimin në gjykatë dhe institucionet përkatëse

c) T'ju këshillojë si të mbronni të drejtat tuaja sipas përcaktimeve ligjore të rastit.



Nëse ju është refuzuar një punë ose përfitimpër shkak të gjinisë suaj, për të cilën keni të drejtë, duhet të provojme se:

1. Jeni trajtuar me pak favorshëm se dikush i seksit të kundërt (psh pagë më e ulët, pushim nga puna, refuzim ngritje në detyrë, leje, kualifikimesh etj).

2. Keni konkuruar, keni fituar por nuk jeni kualifikuar apo promovuar për shkak të përkatësisë gjinore, shtatëzanisë mëmësisë etj.

3. Jeni ngacmuar seksualisht nga punëdhënësi ose kolegët tuaj.

4. Punëdhënësi juaj ka përdorur arsye për të mbuluar diskriminimin gjinor.

Ndërsa ndërgjegjësimi për diskriminimin gjinor është rritur, rastet e diskriminimit në vendin e punës janë bërë më delikate dhe më të vështira për t'u provuar.

- **(Kodi i Punës, Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurave Administrative)**



NE OFROJMË SHËRBIM LIGJOR FALAS !

- Kontaktoni në nr: **08001818**
- Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim
- Adresa: Rr."Abdyl Frasheri", Pallati 10/1, shk.1, ap.3, Tiranë, Shqipëri
- Email: gadc@gadc.org.al

DISKRIMINIMI NË PUNË

Diskriminimi në punë është trajtim i ndryshëm i dy individëve të kualifikuar njësoj për shkak të faktorëve të mëposhtëm.

(Kodi i Punës, Neni 9)

- Racës
- Seksit
- Origjinës kombëtare apo lokale
- Paaftësive mendore dhe fizike
- Moshës dhe orjentimit seksual
- Përkatësisë dhe besimit fetar

Diskriminimi gjinor në vendin e punës ndodh kur "një punonjës ose një punëkërkuar trajtohet ndryshe, ose nuk kualifikohet për shkak të gjinisë dhe/ ose të lidhjes së tij me një organizatë/ grup me specifika të shprehjes gjinore.

FORMAT E DISKRIMINIMIT NË PUNË

Ngacmimi seksual përfshin cdo sjelle të padëshiruar seksuale, shikime, fjalë, prekje, afrim ne tavolinën tuaj të punës, kërkesë llogarie të një natyre të ndryshme nga punonjësit e tjere, kërkesa për favorizime seksuale ose sjellje të tjera të bazuara në seks që ndikon në punën tuaj ose krijon një mjedis pune të frikshem, fyes ose armiqësor për JU.

Ngacmimi seksual në punë mund të ndodh kur burrat ngacmojne gratë, gratë ngacmojnë burrat, burrat ngacmojnë burrat e tjerë dhe gratë ngacmojnë gratë e tjera .

Diskriminimi i bazuar në identitetin gjinor dhe orientimin seksual janë gjithashtu forma të diskriminimit gjinor.

Diskriminimi për shkak të shtatëzaniisë ose mëmësisë është një formë e diskriminimit gjinor

Pagesë e ndryshme mes punonjësve të gjinive të ndryshme për të bërë të njëjtën punë/ të ngjashme

Mohimi i një promovimi në detyrë, rritje page, ose kualifikimi, që u jepet njerëzve të seksit tjetër, të cilët janë njësoj ose më pak të kualifikuar se JU.

(Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi " neni 12, Neni 13 dhe Neni 33)

LIGJET QË JU MBROJNË NGA DISKRIMINIMI NË PUNË

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë ndalon çdo formë diskriminimi, në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion

Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"

Kodi i Procedurës Administrative

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shoqëri"

Direktiva të KES si dhe legjislacioni për ndihmën shoqërore, për paaftësinë, shëndetin mendor etj

CILAT JANË STRUKTURAT QË JU MBROJNË?



GYKATA E RREHIT KU NDODHET VENDI I PUNËS

SHIHNI NËSE EKZISTOJNË MEKANIZMA BRENDA VENDIT TUAJ TË PUNËS.

SHIHNI NËSE JENI ANËTAR I NDONJË SINDIKATE.

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI 08000606

**PLOTËSO FORMULARIN E ANKESËS ME SUBJEKT PUNËSIMI:
WWW.KMD.AL**

POLICIA E SHETIT KUDO NËPËR SHQIPËRI 125

Kjo broshurë është krijuar me mbështetje Financiare nga Komisioni Evropian dhe bashkëfinancuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida). Përmbajtja e kësaj broshure është vetëm përgjegjësi e Rrjetit të Fuqizimit të Gruas në Shqipëri dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron qëndrimin zyrtar të BE apo Sida